

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË PRODHIMIT TË RRUSHIT PËR VERË

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i hartimit të këtij projektvendimi është miratimi për përcaktimin e zonave të prodhimit të rrushit për verë në Shqipëri, bazuar në të dhënat e studimit “Për zonat e kultivimit të vreshtave për verë”, kjo bazuar në pikën 6, të nenit 10, të Ligjit nr. 86/2022 datë 22.12.2022 “Për vreshtarinë dhe verën”, sipas të cilit, zonat e prodhimit të rrushit për verë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky studim propozon zonat e prodhimit të rrushit për verë, bazuar në njohuritë më të mira shkencore dhe social-ekonomike të disponueshme, të siguruara nga institucionet përgjegjëse kombëtare.

Objektivat që priten të arrihen janë:

- Klasifikimi zyrtar i zonave të prodhimit të rrushit për verë;
- Krijimi i një baze shkencore për zonimin;
- Krijimi i zonave homogjene të përshtatme për kultivimin e varieteteve autoktone si: Kallmet, Sheshi i Zi, Sheshi i Bardhë, Vlosh, Serina dhe Debina;
- Bërja pjesë e referencave zyrtare për investimet bujqësore, përfshirë aplikimet për PGI/PDO dhe planifikimet e mbjelljeve të reja;

- Orientimi i investimeve në mbjellje të reja sipas hartës së përshtatshmërisë, duke shmangur zonat me pjerrësi të theksuar, drenazh të dobët ose tokë shumë alkaline.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi i propozuar është parashikuar në Planin Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2025, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 26.12.2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sektori i vreshtarisë dhe verës përfaqëson një nga degët me potencial të lartë të zhvillimit të bujqësisë shqiptare. Tradita shumë shekullore e kultivimit të hardhisë në Shqipëri, e shoqëruar me një diversitet të lartë varietesh autoktone, krijon një bazë të fortë për prodhimin e verërave cilësore dhe konkurruese në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përcaktim i zonave homogjene për kultivimin e vreshtave përfaqëson një hap vendimtar për pozicionimin e verërave shqiptare në tregun e BE-së dhe në tregun global, duke lidhur trashëgiminë e pasur tradicionale me teknologjinë moderne dhe standardet ndërkombëtare.

Përmes përcaktimit të zonave homogjene do të:

- Krijohet harta e zonave klimatiko-pedologjike-topografike për vreshtarinë në Shqipëri;
- Integrohet sektori shqiptar i prodhimit të verës në praktikën e zakonshme të BE-së për verën dhe rrushin;
- Mundësohet mbrojtja e varieteteve autoktone përmes certifikimit dhe përfshirjes së tyre në skemat e cilësisë;
- Ofrohet një bazë shkencore për orientimin e investimeve dhe mbjelljeve të reja, duke maksimizuar rendimentin dhe cilësinë.

Mungesa e një sistemi të qartë zonimi dhe klasifikimi të territoreve sipas karakteristikave klimatiko-pedologjike ka qenë deri tani një pengesë në valorizimin e plotë të potencialit që ofron vendi.

Ligji nr. 86/2022 “Për vreshtarinë dhe verën”, neni 10, parashikon se përcaktimi i zonave të prodhimit të rrushit për verë do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar mbi studime shkencore dhe të dhëna të standardizuara.

Ky proces është i domosdoshëm për përfshirjen e verërave shqiptare në skemën e cilësisë së Bashkimit Evropian (*Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur-TGJM, Emërtimet e Origjinës së Mbrojtur-EOM, termat tradicionalë etj.*) të cilat sot dominojnë tregun e verërave evropiane.

Një element kyç është përcaktimi i zonave homogjene të kultivimit, të cilat bazohen në parametra klimatike (temperatura, netët e ftohta, indeksi i Winklerit), parametra pedologjikë (pH, tekstura, drenazhi, thellësia e tokës etj.) si dhe parametra fenologjikë e varietorë. Kombinimi i këtyre të dhënave lejon krijimin e një Atlasi Kombëtar të Vreshtarisë, i cili do të ketë funksion orientues për prodhuesit dhe institucionet vendimmarrëse.

Përcaktimi i zonave është bazuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në perëndim të Gadishullit Ballkanik, midis koordinatave 39°38'-42°35' V gjerësi gjeografike (Konispol–Vermosh), si dhe 19°16'–21°04' L gjatësi gjeografike (Sazan–Vernik).

Zonat e prodhimit të rrushit për verë u përcaktuan në bazë të përshtatshmërisë klimatike, pedologjike dhe topografike për kultivimin e vreshtave në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila tregon qartë se vendi ka një potencial të lartë për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të verës, me kushte natyrore të favorshme dhe një trashëgimi të pasur varietore.

Rezultatet e analizave tregojnë këto konkluzione kryesore:

Përshtatshmëria klimatike:

- Shumica e zonave të ulëta dhe kodrinore të Shqipërisë (me lartësi <600 m) klasifikohen në rajonet klimatike III–IV sipas indeksit të Winkler (WI-GDD), të cilat janë optimale për kultivimin e varieteteve të rrushit për verë;
- Zonat bregdetare dhe kodrat e buta të Shqipërisë së Mesme dhe Jugut shfaqin kushte shumë të përshtatshme për kultivarët me pjekje të hershme dhe të mesme;


- Indeksi i netëve të ftohta (CI) tregon një bilanc të mirë midis freskisë dhe pjekjes së rrushit, i cili favorizon aromat dhe aciditetin e ekuilibruar në verëra.

Përshtatshmëria e tokës:

- Tokat aluviale dhe ato me teksturë të ekuilibruar (L, SiCL, CL), pH 6.7–7.3 dhe konduktivitet elektrik <2 dS/m përbëjnë kategorinë më të përshtatshme për vreshtari (klasa S1–S2);
- Toka të cekëta, shumë argjilore apo me drenazh të dobët klasifikohen si më pak të përshtatshme (S3–N), por mund të përmirësohen me masa agroteknike si shtimi i lëndës organike dhe drenazhimi artificial;
- Shumë parcela ekzistuese të vreshtarisë ndodhen në zona që përputhen me klasat S1–S2, çka vërteton përputhshmërinë e rezultateve me realitetin prodhues.

Përshtatshmëria topografike:

- Pjerrësitë midis 5-15% janë ideale për cilësi të lartë të rrushit për verë. Zonat me pjerrësi >20% paraqesin kufizime për mekanizimin dhe për këtë arsye janë përjashtuar nga zonat e rekomanduara për mbjellje të reja;
- Orientimi jugor dhe jugperëndimor favorizon ekspozimin ndaj rrezatimit diellor dhe përmirëson pjekjen e fenolëve dhe aromave në rrush.



IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”, si dhe Ligjin nr. 8/2019 datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, si dhe në përputhje me standardet evropiane të hartimit të studimeve të tilla.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*. Ndërsa Ligji nr. 86/2022 “Për vreshtarinë dhe verën”, nga i cili rrjedh detyrimi mbi këtë projektvendim, është përafruar pjesërisht me rregulloren e BE-së nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore”; rregulloret e deleguara: nr. 934/2019, që ka të bëjë me zonat e verës, ku fortësia e alkoolike mund të rritet, praktikat e autorizuara enologjike dhe kufizimet e zbatueshme për prodhimin dhe konservimin e produkteve të rrushit, përqindjen minimale të alkoolit për nënprodukte dhe asgjësimin e tyre, dhe publikimi i skedarëve OIV; nr. 33/2019, që ka të bëjë me aplikimet për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe termave tradicionale në sektorin e verës, procedurat e kundërshtimit, kufizimet në përdorim, amendimet për specifikimet e produktit, anulimi i mbrojtjes, etiketimi dhe prezantimi; nr. 273/2018, që ka të bëjë me skemën e autorizimeve për mbjelljet e hardhisë, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistrin e brendshëm dhe të jashtëm, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimin e informacionit të njoftuar, kontrollet përkatëse dhe dënimet (penalitetet); rregulloret zbatuese: nr. 34/2019, që ka të bëjë me zbatimin e rregullores së BE-së nr. 1308/2013, përsa i përket aplikimeve për mbrojtje të emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe termave tradicionalë në sektorin e verës; nr. 274/2018, që ka të bëjë me skemën e autorizimeve për mbjelljet e hardhive, certifikimin, regjistrin e brendshëm dhe të jashtëm, deklaratat dhe njoftimet e detyrueshme dhe kontrollet përkatëse; nr. 45/2007, që ka të bëjë me përcaktimin e rregullave për sasi të nominale për produktet e paketuara.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi ka përmbajtjen si më poshtë vijon:

Në pikën 1, të projektvendimit propozohet përcaktimi i zonave të prodhimit të rrushit për verë në Shqipëri, sipas tekstit të studimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Studimi përmban në hyrje kontekstin dhe rëndësinë, situatën aktuale të sektorit të vreshtarisë dhe verës në Shqipëri, si dhe nevojat për pasjen e një dokumenti të tillë, më pas përcaktohen objektivat, zonat e studimit, përmes të dhënave dhe metodës së përdorur për llogaritjen e tyre, analizimi i të dhënave, përshtatshmëria e treguesve të përdorur, përcaktimi i zonave, krijimi i hartave të zonave vreshtare homogjene për kultivarët autoktonë.

Në pikën 2 parashikohet që për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucioni kryesor që ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa, studimi është hartuar nga subjekti “GRAMA”, Counsalting & Engineering, përmes një procedure konkurrimi, nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, me fonde të buxhetit të shtetit, referuar Termave të Referencës hartuar me asistencë të projektit FAO.

Ky projektvendim është bashkërenduar edhe me grupet e interesit, (prodhuesit, shoqatat e verës), nëpërmjet emailit zyrtar dhe nuk ka pasur komente.

Ky projektvendim dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, por zbatimi i tij sjell të ardhura të pritshme.